

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe nenit 25 të Ligji për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18)), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi program të shkurtuar mësimor për lëndën **gjuhë gjermane** (gjuhë e dytë e huaj) për **vitin II** të arsimit të mesëm profesional me kohëzgjatje prej katër vjetësh për vitin shkollor 2020/21

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Program i shkurtuar mësimor

GJUHË GJERMANE

(Gjuhë e dytë e huaj)

të dizajnuara në mënyrë modulare

Për vitin II

Teknik hotelierik, teknik hotelierik për turizëm rural, teknik për ngjarje dhe animacion, teknik ekonomi, teknik juridik, adminsitator biznesi, teknik për modelim të veshjeve, teknik për dizajnim të veshjeve, teknik për modelim të këpucëve
profili arsimor / kualifikimi

Ushqim-turizëm/ hotelieri dhe turizëm, ekonomiko-juridik dhe tregtar/ ekonomi, drejtësi dhe tregti /Tekstil-lëkurë /
Tekstil, lëkurë dhe produkte të ngjashme
profesioni/ sektori

Shkup, 2020

Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor për lëndën **gjuhë gjermane (gjuhë e dytë e huaj)** bazohet në rezultatet e të nxënit të parashikuara në programin mësimor për lëndën që realizohet rregullisht në përputhje me plan programin e përcaktuar mësimor.

Programi i shkurtuar përcakton tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë me kohëzgjatje të orës prej 35 minuta, ndërsa respektohet fondi i planifikuar javor i orëve i përcaktuar me programin e rregullt, 2 orë në javë, pra gjithsej 64 orë.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga rezultatet e të nxënit, përmbajtjet dhe konceptet, aktivitetet, metodat dhe kriteret e vlerësimit në programin e rregullt mësimor.

1. Pasqyrë e njësive modulare¹

Njësia modulare 1. Të shprehurit me shkrim
--

Njësia modulare 2. Dëgjim me kuptim

Njësia modulare 3. Lexim me kuptim

Njësia modulare 4. Të shprehurit me gojë
--

2. Rekomandime didaktike

Qëllimi i këtyre rekomandimeve didaktike nga programi i shkurtuar mësimor që do të jetë udhëzues për elementet më të rëndësishme që duhet të përfshihen është të ndihmojë mësimdhënësit për të arritur rezultatet e përcaktuara të të nxënit nga programi i rregullt mësimor për vitin II (e dytë) të arsimit të mesëm profesional me kohëzgjatje prej katër vjetësh. Baza për realizimin e programit të shkurtuar mësimor për lëndën gjuhë gjermane (gjuhë e dytë e huaj) është programi i rregullt mësimor (rezultatet e të nxënit, përmbajtjet dhe konceptet, aktivitetet dhe metodat si dhe kriteret e vlerësimit).

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar mësimor, qëllimi i këtyre rekomandimeve didaktike është të ndihmojnë mësimdhënësit për të arritur qëllimet e përcaktuara duke aplikuar njohurit e reja në fushën e gjuhësisë, pedagogjisë, psikologjisë, d.m.th. përvojat pozitive vendase dhe huaja në lidhje me mësimin e gjuhës gjermane por duke mos kufizuar krijimtarinë e tij/saj.

¹ Në lidhje me njësitë e dhëna modulare dhe fondi i orëve me program të shkurtuar mësimor, mësimdhënësi bën vlerësim të mënyrës dhe thellësisë së përpunimit të secilës njësi modulare individualisht, duke marr parasysh qasjen e balancuar dhe integruar në mësimin e gjithë elementeve gjuhësore

Në planifikimin e mësimdhënies për vitin e parë, merren parasysh përmbajtjet në programet mësimore për lëndët tjera që mësohen në vitin e parë, përkatësisht respektohet parimi i lidhjes mes lëndëve për nga qëllimet dhe përmbajtjet me theks në lidhjen e integruar me përmbajtjet nga gjuha amtare. Gjatë zgjedhjes së aktiviteteve duhet të mbahet llogari për diferencimin dhe diversiteti. Duhet të zgjidhen ose përshtaten aktivitete që i përgjigjen stileve të ndryshme të të nxënësve (vizual, dëgjimor, kinestetike), lloje të ndryshme të inteligjencës (verbale-gjuhësore, matematikore-logjike, muzikore-ritmike, vizuale, hapsinore dhe të tjera), si dhe nivelet e njohurive të nxënësve. Duhet pasur parasysh se motivimi për të mësuar përmirësohet nga format e ndryshme të punës në mësimdhënie (frontale, individuale dhe puna në çifte dhe grupe), si dhe ndryshimi i veprimtarive më të shkurtra dhe më të gjata, rebele dhe më të qeta, periudha të vëmendjes së përqëndruar dhe relaksimi i nxënësve gjatë orës së mësimi. Mësimi i gjuhës gjermane bazohet në të mësuarit holistik që përfshin aspektet kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve, gjegjësisht mësimdhënësi do të integroj komponentët e ndryshëm në mënyrë që gjuha të mësohet në mënyrë funksionale. Sipas kësaj që thamë më lartë, në mësimin e gjuhëve të huaja nuk mund të ndahen gjegjësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve sipas komponentëve /aftësive individuale.

Mësimdhënia për këtë grupmoshë është e orientuar drejt të mësuarit kognitiv me shpjegim të shtuar të strukturave gjuhësore me zbatim të vetëdijshëm të strukturave gjuhësore në kontekst dhe vendosjen graduale të gjuhës gramatikore. Mësimdhënësi duhet të inkurajojë dhe zhvillojë autonominë e nxënësve përmes aktiviteteve dhe detyrave që u mundësojnë nxënësve të marrin përgjegjësi për mësimin e tyre dhe njohuritë që marrin në kontekst formal të të mësuarit (në klasë) dhe ta përdorin atë jashtë. Nga kjo rrjedh se në orët e gjuhës gjermane marrin njohuri gjuhësore dhe sociopragmatike dhe njohuri në lidhje me vet procesin e të mësuarit. Nga e gjitha kjo vijon që mësimdhënësi duhet t'i mësojë nxënësit se si të mësojnë më lehtë dhe më shpejt, si të ruajnë ato që janë mësuar dhe si t'i përdorin njohuritë në situata të reja, jashtë klasës, t'i njoh ata me qëllimet dhe përmbajtjen e aktiviteteve/ detyrat/materialet dhe strategjitë e të nxënësve që ato i aplikojnë në nivelet më të larta të të mësuarit. Nga mësimdhënësi pritët që t'i mësojë nxënësit të zbatojnë strategji të suksesshme të të nxënësve.

Si në programin e rregullt mësimorë e cila përcaktohet në aftësitë gjuhësore (dëgjim me kuptim, lexim me kuptim, të shprehurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim) si njësi modulare, edhe në kuadër të programit të shkurtuar rekomandohen komponentët e gjuhës (strukturat gramatikore, njësitë leksikore, funksionet gjuhësore dhe përmbajtjet ndërkulturore) të përvetësohen të integruara me aftësitë gjuhësore. Duke pas parasysh qëllimin e këtij programi mësimor, më saktësisht për nxënësit nga arsimi i mesëm profesional, rekomandohet që mësimdhënësi të theksojë funksionet gjuhësore dhe njësitë

leksikore që janë të rëndësishme për profesionin e dhënë duke zvogëluar fjalorin e përgjithshëm. Zgjerimi i strukturave gramatikore të bashkohet me praktikën e strukturave gramatikore tani më miratuara. Orët e parashikuara në programin e rregullt për përforcimim e njësive të mësuara duhet të zvogëlohen, ndërsa aktivitetet duhet të integrohen në orët e parashikuara për përmbajtje të reja mësimore. Sa i përket metodave dhe aktiviteteve rekomandohet zvogëlimi i tyre, përkatësisht përzgjedhja e metodave dhe aktiviteteve më efektive për adaptimin e përmbajtjes së dhënë dhe të përshtatura me kohëzgjatjen e mësimit prej 35 minuta.

Duhet të theksohet se në këtë program të shkurtuar për lëndën gjuhë gjermane, numri i orëve për njësi individuale modulare mund të ndryshojë, përkatësisht mësimdhënësi është i lirë dhe mund të organizojë mësimin dhe orët duke lidhur atë që është mësuar tash më si dhe bashkimin e njësive mësimore.

3. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normën për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programi i shkurtuar mësimor për lëndën **gjuhë gjermane** (gjuhë e dytë e huaj) **për vitin II (e dytë)** të arsimit të mesëm profesional me kohëzgjatje prej katërvitesh e përcaktoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
